



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1030/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Hasan Shala, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Ramiz Rraci kandidat për asamblenë komunale në Gjakovë nga subjekti politik Aleanca Kosova e Re (AKR), paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ)-Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) për shkak të mungesës së votave, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

V E N D I M

MIRATOHET si e bazuar ankesa e Ramiz Rraci nga subjektit politik AKR.

URDHËROHET KQZ që të rinumëroj fletëvotimet në Vendvotimet 0215C/02R 0202C/04R dhe 0204/04R, dhe ky numërim të përfshihet në rezultatin përfundimtar të Zgjedhjeve Lokale të 3 Nëntorit 2013.

A R S Y E T I M

PZAP-i me datën 03.12.2013 ka pranuar një ankesë nga Ramiz Rraci kandidat për asamblenë komunale në Gjakovë nga subjekti politik AKR, në të cilën pretendon se në bazë të dokumentit lista e freskuar e datës 08.11.2013 e lëshuar nga përfaqësuesi zyrtar i autorizuar nga KKZ-ja në Gjakovë vërtetohet se numri total i votave të fituara për 3 kandidatët për çështjen e kontestuar të inicuar nga kandidati Ramiz Rraci konstatohet se kandidati Ramiz Rraci me nr. Rendor i listës 30 ka fituar 292 vota, kandidati Etor Hoxha nr.rendor i listës 28 ka fituar 297 vota dhe kandidati Gent Olloni nr, rendor i listës 15 ka fituar 279 vota

Në bazë të dokumentit lista e freskuar e datës 08.11.2013 konstatohet se mungojne te dhenat per vendvotimin 0202C/04R ne shkollen fillore Mustafa Bakija.

Poashtu sipas parashtruesi mungojnë të dhënat për vendvotimin 0204C/04R në shkollen fillore K.Kusari.

Andaj parashtruesi i ankesës thekson se në bazë të raportit të rezultateve përfundimtare nga QNR-ja rezultatet e kandidatëve nëpër komuna për zgjedhjet lokale 2013 parashtruesit të ankesës Ramiz Rracit nuk i janë llogaritur dhe numëruar votat nga QNR-ja ku gjatë numërimit te votave kanë gabuar ose kanë harruar të i llogaritin

votat. Andaj me këtë rast parashtruesi i ankesës kërkon që të bëhet rinumërimi i kutive të votimit 0215C/02R ; 0202C/04R dhe 0204C/04R

PZAP-i pas shqyrtimit dhe analizimit gjeti se:

- **ankesa është e bazuar**

PZAP-i nga shkresat e lëndës të ofruara nga pala ankuese si dhe nga hetimi i bërë në QNR ka vërejtur se ka pasur parregullsi pasi që gjatë hetimit të bërë në QNR ka vërtetuar se nuk përputhet FPR-ja për këto vendvotime 0204c/04R 0202C/04R dhe 0215/02R me FRK-të ngase në të tri rastet nuk janë plotësuar FRK-të nga vendvotimet e lartcekura. Andaj PZAP-i në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve në këto vendvotimeve. Andaj PZAP nga këto arsye e më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura si dhe në mbështetje të 117.4 lidhur me nenin 118.1 dhe 119.5 të LZP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
A nr. 1030/2013 më datën 06.12.2013.

**Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala**



Këshillë Juridik:

Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankese në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njezetekater (24) oreve nga moment i marrjes së vendimit nga PZAP-i